



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1216, datë 07. 04. 2010

Për

“Miratimin e pagesës për regjistrimin domain cc.TLD.al”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Elda Topi, në mbledhjen e datës 07.04. 2010, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen e pagesës për regjistrimin e domain CCTLD.al.

BAZA LIGJORE:

1. Shkronjat k) dhe p) të nenit 8, pika 1 e nenit 114, pika 1 e nenit 115 dhe neni 138 të ligjit Nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**Ligji nr. 9918**);
2. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendshme të AKEP (**Rregullorja e Brendshme**), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918;
3. Rregullore “Për regjistrimin dhe Administrimin e Emrave të Domain-eve nën. AL dhe nëndomain-et .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al” (**Rregullorja**).

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar :

V Ë R E N:

1. AKEP, sipas shkronjës k) të nenit 8 të ligjit nr. 9918 është autoriteti kompetent që administron domain cc.TLD.al, nëndomainet e tij, si dhe ENUM.
2. Për administrimin e domain cc.TLD.al dhe nëndomainet e tij, ERT si autoriteti përgjegjës ka nxjerrë Rregulloren përkatëse të miratuar me vendimin nr. 437, datë 21.02.2008 të Këshillit Drejtues. Kjo rregullore është në fuqi edhe pas zëvendësimit të ERT nga AKEP.
3. Pagesa për regjistrimin e domain.al deri më tani është paguar nga poseduesit e tij në nivelin 75USD çdo dy vjet, sipas përcaktimit të parashikuar në vendimin nr. 75, datë 06. 02. 2003 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e pagesave që kryhen ne ERT” (VKM Nr. 75).
Por, pagesa në ERT/AKEP për regjistrimin e domain-it nuk ka qenë parashikuar në ligjin në fuqi në momentin e nxjerrjes dhe hyrjes në fuqi të VKM Nr. 75, ligjin nr. 8618, datë 14.06.2000 “ Për Telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji nr. 8618). Detyrimi për pagesën e regjistrimit të domanit ka qenë i përcaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë vetëm në VKM nr. 75.
Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 9918, AKEP-i për herë të parë përcaktohet me ligj si autoriteti kompetent për administrimin e domain.al dhe nëndomeinet e tij. Për rrjedhojë, të gjitha rregullimet dhe aktet nënligjore që lidhen me administrimin e domain.al duhet të rrjedhin nga ky ligj.
Nga ana tjetër, ligji nr. 9918, lidhur me pagesat që kryhen në AKEP, në pikën 2 të nenit 119 të tij, përcakton se vetëm pagesat që kryhen për përdorimin e frekuencave dhe numrave, miratohen nga Këshilli i Ministrave.
Në këto rrethana, pagesa për regjistrimin e domain.al është një pagesë që duhet të rregullohet nga AKEP me akt administrativ – Vendim të Këshillit Drejtues, për këtë qëllim. Niveli i pagesës për regjistrimin e *domain.al* duke qenë se AKEP nuk është një subjekt juridik fitimprurës, duhet të jetë në vlerën e mbulimit të kostove administrative.
4. AKEP, në kuadër të hartimit të propozimit për miratim nga Këshilli i Ministrave në zbatim të pikës 2 të nenit 119 të ligjit nr. 9918, ka përfshirë në projektaktin e përgatitur edhe propozimin për pagesën e regjistrimit të domain.al në nivelin 2000 lekë për cdo dy vjet. Ky projektakt i është nënshtruar edhe procesit të këshillimit publik sipas nenit 110 të ligjit nr. 9918 dhe aktualisht gjendet në fazën e shqyrtimit për miratim nga Këshilli Drejtues, të propozimit përfundimar për Këshillin e Ministrave. Niveli i propozuar i pagesës nuk është kontestuar nga grupet e interesit.
5. Këshilli i Ministrave nëpërmjet Kryeministrit, në kuadër të iniciativave me qëllim nxitjen e projekteve për futjen e internetit në cdo shtëpi, ka kërkuar publikisht më se një herë uljen e nivelit të pagesës për regjistrimin e domanit, në nivelin më të ulët të mundshëm dhe sa më shpejt që të jetë e mundur.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Duke marrë në konsideratë që:

- Në pikën 2 të nenit 119 të ligjit nr. 9918 nuk përcaktohet kërkesa që pagesa në AKEP për regjistrimin e domain.al duhet të miratohet nga Këshilli i Ministrave;
- VKM Nr.75, lidhur me pagesën për regjistrimin e domain-it nuk ka qenë një detyrim që buronte nga ligji nr. 8618 në fuqi në atë kohë;
- Zbatimi i VKM Nr. 75, me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 9918, sipas nenit 138 të tij aplikohet deri në nxjerrjen e akteve të reja në zbatim të këtij ligji;
- Projektakti i propozuar përmbush kërkesat ligjore të përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative;
- Kërkesën e Këshillit të Ministrave nëpërmjet Kryeministrit, për uljen e nivelit aktual të pagesës për regjistrimin e domain-it, bazuar në shkronjat k) dhe p) të nenit 8, pikën 1 të nenin 114 dhe pikën të nenit 115 të ligjit nr. 9918, si dhe pikën 17 të nenit 21 të Rregullores së Brendëshme,

V E N D O S:

1. Të miratojë pagesën për regjistrimin e domain-it cc.TDL.al, në nivelin 2000 lekë për çdo dy vjet.
2. Pagesa të kryhet në AKEP nga poseduesit sipas përcaktimeve të parashikuara në Rregulloren “Për regjistrimin dhe Administrimin e Emrave të Domain-eve nën. AL dhe nëndomain-et .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al”
3. Akti i miratuar të publikohet në faqen e internetit www.akep.gov.al

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARET E KËSHILLIT DREJTUES:

- 1. Alketa MUKAVELATI**
- 2. Benon PALOKA**
- 3. Ibsen ELEZI**
- 4. Zamira NURCE**

RELACION SHPJEGUES MBI PROJEKTAKTIN

Pagesa për regjistrimin e domain.al është një pagesë që aktualisht kryhet në AKEP në përputhje me Rregulloren “Për regjistrimin dhe Administrimin e Emrave të Domain-eve nën. AL dhe nëndomain-et .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al” (**Rregullorja**), miratuar me vendimin nr. 437, datë 21.02.2008 të Këshillit Drejtues të ERT, në vlerën 75 USD çdo dy vjet, sipas përcaktimit të parashikuar në vendimin nr. 75 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e pagesave që kryhen në ERT” (VKM Nr. 75). Megjithëse ligji në fuqi në momentin e nxjerrjes dhe miratimit të Rregullores, ligji nr. 8618, datë 14.06.2000 “Për Telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (**ligji nr. 8618**), nuk përcaktonte ERT si “autoritetin përgjegjës” dhe as nuk parashikonte detyrimin që pagesa për regjistrimin e domain.al të miratohej nga Këshilli i Ministrave, pagesa për regjistrimin e domain-it ishte përcaktuar në VKM Nr. 75.

Me shfuqizimin e ligjit nr. 8618 dhe hyrjen në fuqi të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**ligji nr. 9918**), në kompetencat e AKEP, organi rregullator i fushës që zëvendësoi ERT-në, përcaktohet edhe kompetenca e administrimit të domain cc.TLD.al, nëndomainet e tij, si dhe ENUM. Kjo kompetencë, më parë e përcaktuar vetëm në Rregulloren e ERT për këtë qëllim, me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 9918 kaloi në nivelin e normimit ligjor. Ky fakt kërkon që aktet nënligjore plotësuese të nxirren vetëm nëse ky ligj, (ose ligje të tjera referuese) përcaktojnë një detyrim të tillë.

Lidhur me pagesat që kryhen në AKEP, ligji nr. 9918 nuk përcakton detyrimin që pagesa për regjistrimin e domain.al, propozohet nga AKEP dhe miratohet nga Këshilli i Ministrave, sië është përcaktuar në rastin e pagesave për frekuencat dhe numrat, konkretisht në pikën 2 të nenit 119 të tij. Gjithashtu as edhe ndonjë ligj tjetër në fuqi në Republikën e Shqipërisë nuk e parashikon një detyrim të tillë.

Në këto rrethana ligjore, pagesa për regjistrimin e domain.al është një pagesë që duhet të rregullohet nga AKEP me akt administrativ – Vendim të Këshillit Drejtues, për këtë qëllim. Niveli i pagesës për regjistrimin e *domain.al* duke qenë se AKEP nuk është një subjekt juridik fitimprurës, duhet të jetë në vlerën e mbulimit të kostove të tij administrative.

Megjithëse e panevojshme, në projektaktin e hartuar nga AKEP në kuadër të propozimit që do t'i paraqitet Këshillit të Ministrave për miratim në zbatim të pikës 2 të nenit 119 të ligjit nr. 9918, është përfshirë edhe propozimi për pagesën në AKEP të regjistrimit të domain.al në nivelin 2000 lekë për çdo dy vjet. Niveli i propozuar i kësaj pagese nuk rezulton të jetë kontestuar nga palët e interesuara gjatë procesit të këshillimit publik të kryer nga AKEP për këtë qëllim sipas nenit 110 të ligjit nr. 9918.

Ndërkohë, Këshilli i Ministrave nëpërmjet Kryeministrit, në kuadër të iniciativave me qëllim nxitjen e projekteve për futjen e internetit në çdo shtëpi, ka kërkuar publikisht më se një herë uljen e nivelit të pagesës për regjistrimin e domainit, në nivelin më të ulët të mundshëm dhe sa më shpejt që të jetë e mundur.

Për këto arsye, duke qenë se:

- Në pikën 2 të nenit 119 të ligjit nr. 9918 nuk përcaktohet kërkesa që pagesa në AKEP për regjistrimin e domain.al duhet të miratohet nga Këshilli i Ministrave;
- Pagesa për regjistrimin e domain-it e përcaktuar në VKM Nr. 75 nuk ka qenë një kërkesë që buronte nga ligji nr. 8618 në fuqi në atë kohë apo ndonjë ligj tjetër;
- Zbatimi i VKM Nr. 75, me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 9918, sipas nenit 138 të tij aplikohet deri në nxjerrjen e akteve të reja në zbatim të këtij ligji. Në kushtet kur ligji nr. 9918 nuk e përmban kërkesën për miratimin nga Këshilli i Ministrave të pagesës për regjistrimin e domain.al, kjo pagesë

nuk ka bazë ligjore të përfshihet në propozimin që AKEP do ti paraqesi Këshillit të Ministrave nëpërmjet Ministrit të Shtetit për Reformat dhe Marrëdhëniet me Kuvendin lidhur me miratimin e pagesave që kryhen në AKEP sipas pikës 1 të nenit 119 të këtij ligji. Për këto arsye AKEP duhet të normojë pagesën për regjistrimin e domain.al nëpërmjet një akti administrativ të nxjerrë prej tij në zbatim të kompetencës ligjore të përcaktuar në shkronjën k) dhe shkronjës p) të nenit 8 të ligjit nr. 9918.

- Këshilli i Ministrave nëpërmjet Kryeministrit, ka kërkuar uljen e nivelit aktual të pagesës për regjistrimin e domain-it, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në nivelin më të ulët të mundshëm; Këshilli Drejtues i AKEP bazuar në shkronjat k) dhe p) të nenit 8, pikën 1 të nenin 114 dhe pikën të nenit 115 të ligjit nr. 9918, si dhe pikën 17 të nenit 21 të Rregullores së Brendëshme, mund të vendosi:

1. Të miratojë çmimin e pagesës në AKEP për regjistrimin e domain-it cc.TDL.al, në nivelin 2000 lekë për çdo dy vjet.
2. Pagesa të kryhet në AKEP nga poseduesit sipas përcaktimeve të parashikuara në Rregulloren “Për regjistrimin dhe Administrimin e Emrave të Domain-eve nën. AL dhe nëndomain-et .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al”